

E ARDHMJA NË DUART TONA



GAZETARËT DEMOKRATË

ARTI (10), ELESJA (10), TONI (10), FIONA (10), ALTIN (10), JETA (10), BLENDI (10)



Ne mendojmë që demokracia është sistem i mirë i qeverisjes dhe jemi të lumtur që Kosova e ka një sistem të tillë

Demokracia është sistem i qeverisjes ku fjalën kryesore e ka populli. Demokracia ka filluar në vitin 507 p.e.s. në Athinë të Greqisë. Demokracia e atëhershme nuk ishte e barabartë për të gjithë. Në këtë demokraci nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë në vendime të varfërit, gratë dhe as të moshuarit.



Gazetarët duke punuar

Demokracia është zhvilluar më shumë në këto vitet e fundit, sepse janë bërë të drejtat e barabarta midis të gjithë njerzëve. Në demokracinë e tashme kemi të drejtë të shprehemi lirshëm, të marrim pjesë në aktivitete të ndryshme etj. Sot kemi të drejtë të argëtohemi, të arsimohemi, të ushqehemi, të kemi një emër, të kemi një familje, të kemi punë, të kemi barazi gjinore

e shumë të drejta të tjera. Ne kemi të drejtë të zgjedhim kryetarin e komunës apo deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, por kur t'i mbushim 18 vjeç, sepse kështu është me ligj.

Demokracia ndahet në demokraci përfaqësuese dhe të drejtpërdrejtë. Demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli merr vendime direkt pa ndihmën e përfaqësuesve, kurse demokracia përfaqësuese është kur populli ka të drejtë të merr vendime politike, por përmes përfaqësuesve të tyre, të cilët janë deputetët. Demokracia përfaqësuese ndahet në demokraci parlamentare dhe presidenciale. Shteti i Republikës së Kosovës është formuar me 17 Shkurt më 2008. Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik. Ajo ka demokraci parlamentare, ku populli përfaqësohet nga deputetët. Ne mendojmë se Kosova ka demokraci të zhvilluar dhe jemi krenarë që shteti ynë ka pasur një grua Presidente. Kjo tregon se në Kosovë edhe gratë kanë të drejta.



Gazetarët e demokracisë

E DREJTA E VOTËS

OLTI (10), KRONI (10), ARLINDI (10), DRILON (10), ENDRIT (10), ALKETA (10), BERNA (10)

Ne sot votuam dhe mësuam për zgjedhjet. Ju ftojmë ta lexoni artikullin tonë

Ne çdo ditë hasim në zgjedhje p.sh. ne zgjedhim rrobat tona, zgjedhim ngjyrat e preferuara, filmat që shohim etj. Mirëpo, të drejtën për të marrë pjesë në procesin e zgjedhjeve, do ta kemi kur të mbushim 18 vjet, sepse atëherë do të jemi të pjekur dhe vota jonë duhet të jetë e pavarur.


Kemi dy lloje të zgjedhjeve, ato komunale dhe qendrore. Po ashtu, në Kosovë kemi një zonë zgjedhore. Zgjedhjet ndodhin një herë në katër vjet. Zgjedhjet janë shumë të rëndësishme, sepse ne zgjedhim deputetët dhe ata na përfaqësojnë neve (popullin). Vota jonë duhet t'i besohet personit i cili i ka cilësitë e mira. Një votë e jona ka vlerë shumë të madhe sepse e bën ndryshimin. Ne gjithmonë do të votojmë në të ardhmen.



Gazetarët „Qershia“



Një votë e jona bën ndryshimin



Qytetari ka të drejtë të votoj i pavarur



Kur e votojmë përfaqësuesin e duhur, ai na lehtëson jetën dhe na bën të lumtur



Ne sot votuam dhe zgjedhëm deputetin tonë nga partia „Edukata Fizike“

VENDI KU MIRATOHEN LIGJET

ARESA (10), ELONA (10), LUARA (10), MELONI (10), ADRIATIKU (10), BLEONI (10)




Kuvendi dhe rëndësia e tij

Në demokraci qytetarët kanë të drejtën e të shprehurit lirshëm. Demokraci do të thotë udhëheqje e popullit. Në Kosovë ekziston demokracia përfaqësuese parlamentare. Në demokracinë parlamentare përfaqësuesit zgjedhen nga populli. Përfaqësuesit ndryshe quhen deputetë. Kuvendi është institucion në të cilin diskutohen, shqyrtohen problemet dhe çështjet e vendit tonë. Aty miratohen ligjet dhe kontrollohet Qeveria si dhe miratohet buxheti i vendit. Në Kuvend janë 120 deputetë, ku 100 vende janë për deputetët të cilët e përbëjnë shumicën, kurse 20 prej tyre janë për komunitetet jo shumicë si boshnjakët, turqit, serbët, goranët, egjiptianët, ashkalinjtë dhe romët.

Në Kuvend ka komisione të ndryshme parlamentare. Këto komisione janë grupe punuese me deputetë, të cilat merren me propozimet e ndryshme që bëhen në Kuvend. Nëse në Kuvend propozohet një ligj për kujdesin shëndetësor, atëherë merret Komisioni për Shëndetësi, ndërsa nëse propozohet një ligj për arsim merret Komisioni për Arsim, kështu me radhë.

Ndërsa, ligjet janë rregulla, të cilat nuk duhet të thyhen dhe nëse i thyejmë ato, atëherë ne gjykohe mi. Nëse një qytetar i thyen limitet e shpejtësisë gjatë vozitjes së makinës, ai dënohet me një gjobë të caktuar. Pra, ne si qytetarë duhet t'i respektojmë rregullat dhe ne si qytetarë kemi të drejta të barabarta. Kemi të dre-

jtën e shkollimit, të lojës, të familjes, të strehimit, të punës, të zgjedhim profesionin që dëshirojmë etj.



Kutia e votimit



Autorët e artikullit

AKTIVISTËT DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE

ERLIS (10), ELTON (10), EURONA (10), KANITA (10), RIDVAN (10), YLL (10)

Të jesh qytetar (fëmijë) aktiv do të thotë që të jesh në gjendje që çdo herë të punosh jo vetëm në të mirë të familjes tënde, por në të mirë të të gjithë fëmijëve. E si mund ta bëjmë ne këtë, ne do t'iu tregojmë në artikullin tonë.

Demokracia ju mundëson të gjithë qytetarëve që të jetojnë të lirë dhe të barabartë me njëri-tjetrin. Por, kënd e quajmë qytetar në demokraci? Qytetar e quajmë secilin individ që posedon mjet identifikimi, që është gjithashtu valid për një shtet të caktuar. Ne si fëmijë si mjet identifikimi që jemi qytetarë të Kosovës e kemi pasaportën si dhe çertifikatën e lindjes. Si të tillë që jemi, ne kemi të drejta por po ashtu kemi edhe përgjegjësi.

Për të drejtat e fëmijëve, ju ftojmë të lexoni artikullin më poshtë.



Të gjithë ne jemi qytetarë (fëmijë) aktiv

Në vizatimet mëposhtë do të informoheni më shumë rreth asaj se si ne si fëmijë mund të jemi aktiv për vendin tonë



Një lagje para pastrimit



Disa fëmijë duke pastruar ambientin (lagjen)

Ashtu siç e cekëm më lart, në këtë pjesë të artikullit do t'iu informojmë më shumë rreth të drejtave të fëmijëve. Të drejtat e fëmijëve sipas nesh janë një ndër elementet kryesore të demokracisë.

Konventa e parë për të Drejtat e Fëmijëve është miratuar në vitin 1989 nga Karta e Kombeve të Bashkuara dhe që hyri në fuqi me 30 shtator të vitit 1990.

Kjo Konventë, të gjithë fëmijëve pa dallim race, gjinie, feje ua mundëson të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të mos diskriminohen nga askush. Këtu bëjmë pjesë edhe ne. Ashtu siç edhe kërkon Konventa për të Drejtat e Fëmijëve që të gjithë të trajtohen të barabartë, ashtu edhe ne u trajtuam sot, të gjithë të barabartë.





IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Gafurri“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë